


**AKT-THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISE "BLEDI" SH.P.K.**



**NENI 1**

**-NAZIF HYSA**, I biri I Sadikut I datelindjes 4 Korrik 1957, lindur dhe banues ne I agjen "Pjeter Budi" Burrel , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me kombesi e shtetesi shqiptare, sot me date 18-03 -2000 ka vendosur qe shoqeria e tije e quajtur "**BLEDI**" sh.p.k te marre formen e nje shoqerie tregtare me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me ligjin Nr. 7638 date 19.11.1992 dhe ligjin nr. 7667 date 28.01.1993.

**NENI 2**

Shoqeria vepron ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe ne perputhje me dispozitat e statutit qe I bashkelidhet ketij akti themelimi

**NENI 3**

Emeri I shoqerise eshte "**BLEDI**" sh.p.k.

**NENI 4**

Objekti I veprimtarise private I kesaj shoqerie do te jete:

Kat I Punime dheu, sistemime ,taracime terenesh etje. Kat II Prodhime material inerte, rere, cakull, gure, mermer etje. Kat 3/a Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etje, deri ne dy kate dhe kompletimi me istalimet e nevojshme per to. Kat 4/a Ndertime rruge Kat V dhe IV. Kat 6/a Ndertim vepera arti te vogela deri ne 6 metra. Kat 8/b Ndertim ujsjellesa dhe kanalizime. Kat 8/c Ndertim vepera kullim, ujitje toke dhe impjante vaditese. Kat 8/g Punime mbrojtje dhe sistemi hidraulik. 9/a Sillosa,kulla, kulla uji etje prej beton armeje. 9/b Sillosa, kulla, kulla uji etje metalike. Kat 10/a Rikonstruksione godinash civile e ekonomike , veshje fasadash etje, prodhimin, perpunimin e lendeve te para ,per ndertim materiale inerte si dhe eksport importin e tyre: import eksportin dhe tregtin me shumice e pakice te mallrave industriale, bujqesore, ushqimore, materialeve te ndertimit, makinerive e mjeteve te te gjitha llojeve sidomos ne fushen e ndertimit, artikujve shtepiake elektrik, hidrosanitare, pllakave et ulla te te gjitha llojeve, duralominit e nen produkteve te tije, automjeteve e pjeseve te kembimit, ngritjen e linjave per material inerte.

**NENI 5**

Selia e shoqerise eshte ne Burrel , me te drejt hapje filjalesh , degesh e perfaqesish ne te gjith teritorin e vendit dhe jashte tije.

**NENI 6**

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100000 (njqind mije) leke, I derdhur dhe shlyer tersisht nga Ortaku I vetem. Shuma e derdhur per formimin e kapitalit themeltar do te vertetohet me ane te nje dokumenti te leshuar nga banka, ose te depozitimit pran zyres se noterise.



**NENI 7**

Ortak I vetem I shoqerise eshte **NAZIF HYSA**

**NENI 8**

Administrator I shoqerise eshte **NAZIF HYSA**

**NENI 9**

Drejtues teknik I shoqerise eshte **NAZIF HYSA**  
Kohe zgjatja e aktivitetit te shoqerise eshte mbi 10 vjet.

**NENI 10**

Organet drejtuese te shoqerise "**BLEDI**" sh.p.k jane

Ortaku I vetem

Administratori

Menyra e marrjes se vendimeve nga ortaku I vetem I shoqerise kompetencat dhe funksionet e administratorit , ndarja e fitimit, emerimi I ekspertit kontabel, marredhaniet e punesimit, ndryshimet e mundeshme si dhe mbyllja e shoqerise, jane percaktuar ne statutin bashkengjitur ketij akti themelimi.

**NENI 11**

Per cka nuk eshte percaktuar ne kete akt themelimi do te referohet ligjit " Per shoqerit tregtare" dhe ligjit "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen plotesuar ne te"

**NENI 12**

Ky akt themelimi eshte hartuar nga ortaku I vetem me vullnetin e tij te lire dhe te plote.

**PER SHOQERINE "BLEDI" SH.P.K**

**ORTAKU I VETEM**

**NAZIF HYSA**

## STATUTI

### I

## SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE

## KUFIZUAR "BLEDI" shpk BURREL



Ne baze te ligjit Nr. 7512 dt. 10 gusht 1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire, veprimtarise se pamvarur dhe privatizimit" te kodit tregtare dhe te akteve te jera ligjore, ne burrel sot dt. 10. Shtator 1999 une Nazif Hysa me banim ne lagjen "Pjeter Budi" te qytetit Burrel, me vullnetin tim te lire dhe te plote ne perputhje me legjislacionin shqiptare vendosa te krijoj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar ndertimi "BLEDI" shpk Burrel.

### KREU I

#### DISPOZITA TE PERGJITESHME.

##### Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "BLEDI" shpk Burrel eshte person juridik I pavarur, ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet brenda kufijve te percaktuar ne ligjin Nr. 7512 dt. 10 gusht 1991, kodit tregetar dhe akteve te tjera ligjore.

##### Neni 2

Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "BLEDI" shpk Burrel e ushtron veprimtarine e saj private ne baze te ekonomise se tregut te lire.

##### Neni 3

Shoqeria ka derdhur kapitalin e saj me qellim qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private si edhe te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapacitetin fillestar

##### Neni 4

Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "BLEDI" shpk Burrel, eshte person dhe fiton zotesi per te vepruar me rregjistrimin ne gjukaten e rrethit Tirane si edhe me paisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga organi kompetent.



## **EMRI, QENDRA, TERITORI**

### **Neni 5**

Emertimi I shoqerise do te jete: Shoqeria Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar "BLEDI" shpk Burrel.

### **Neni 6**

Selia e shoqerise tregtare "BLEDI" shpk Burrel do te jete ne qytetin e Burrelit dhe konkretisht ne lagjen "Pjeter Budi". Shoqeria mund te zhvilloje aktivitetin e saj dhe te cele filiale ne te gjith teritorin e Republikes se Shqiperise.

## **OBJEKTI**

### **Neni 7**

Objekti I veprimtarise dhe aktiviteti I kesaj shoqerie do te jete: Punime dheu, sistemime, taracime terrenesh, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, ndertime rruge te kategorise se peste dhe te katert, ndertime ujesjellsa e kanalizime, ndertim vepra kullimi e ujitje toke e impiante vaditese, punime mbrojtje dhe sistemi hidraulik, sillosa, kulla, kulla uji prej B/Armeje, metalike, rikonstruksione godinash civile ekonomike, veshje fasadash etj.

## **AFATI I VEPRIMTARISE.**

### **Neni 8**

Aktiviteti tregtare I shoqerise do te zhvillohet me nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet.

### **Neni 9**

Shoqeria eshte e detyruar te mos ndryshoje destinacionin e saj. Ndryshimi I destinacionit I veprimtarise ekonomike e financiare brenda dy vjetesh mund te behet me lejen e organeve kompetente shteterore.

## **KAPITALI I SHOQERISE**

### **Neni 10**

Kapitali I shoqerise tregtare "BLEDI" shpk Burrel perbehet nga shuma prej 100.000 lekesh te depozituara prane bankes se Kursimeve Dega Mat.

**Neni 11**

Transferimet e kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt noterial. Shoqeria apo te tretet duhet te respektojne keto transferime sapo ti behen te ditur asaj.

**Neni 12**

Pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato mund tu kalojne bashkeshorteve, paraardhesve dhe pasardhesve.

**DREJTIMI ADMINISTRATIV**

**Neni 13**

Shoqeria tregtare "BLEDI" shpk Burrel do te kete si administrator Z. Nazif Hysa.

**Neni 14**

Sipas akteve ligjore shlyhen detyrimet ndaj organeve shtetore, personave juridike vendas dhe te huaj etj.

**KREU I DYTE**

**MARREDHENIET EKONOMIKE E FINANCIARE**

**Neni 15**

Shoqeria tregtare "BLEDI" shpk Burrel mund te lidhe kontrata me sektore shtetore drejtperdrejt me tregun e lire si edhe me persona juridike e fizike, vendas dhe te huaj, sipas legjislacionit ne fuqi per eksport import.

**Neni 16**

Ne veprimet kontraktuale shoqeria perfaqesohet nga administratori Z. Nazif Hysa ose persona te tjere te autorizuar prej tij.

**Neni 17**

Te drejtat dhe detyrat qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine dhe punonjesit e saj.

**Neni 18**

Sipas rregullave te caktuara nga ministria e Financave dhe akteve te tjera ligjore, shoqeria pergjigjet per kontabilitetin fiskal, afatet e derdhjes se detyrimeve ndaj shtetit, sigurimeve shoqerore etj. Sipas ligjeve te tatimit mbi fitimin percakton tatimin per veprimtarine tregtare te shoqerise.



Shoqeria ka te drejte te cele llogari prane bankave te vendit, te huaja ne Shqiperi dhe te kryej veprimet e likujdimit nepermjet tyre.

**Neni 19**

Per sigurimin e veprimtarise ekonomike shoqeria ka te drejte te vetefinancohet ne leke ose valute te huaj.

**Neni 20**

Shkembimin e monedhes shqiptare ne monedhe te huaj e anasjelltas mund ta beje ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar ose me tregun e lire privat te valutes.

**Neni 21**

Te ardhurat nga veprimtaria private do te sigurohen sipas cmimeve qe I cakton vete shoqeria.

Cmimet dhe tarifate do te caktohen sipas kerkeses dhe ofertes

**Neni 22**

Per pasqyrimin e aktivitetit tregetar administratori, ose persona te tjere te caktuar nga drejtuesi ligjor, jane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullt financiar dhe regjistrat perkates sipas ligjeve te vecanta.

**KREU I III**

**Neni 23**

Themeluesi I shoqerise per realizimin e veprimtarise merr ne pune punonjes me kontrate pune vjetore ose sezonale. Marredheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen sipas kontrates se lidhur lirisht midis paleve.

**Neni 24**

Punonjesit gezojne lejen vjetore dhe leje plotesuese sipas kritereve te percaktuara ne kontraten e punes dhe ne mungese te tyre sipas kodit te punes te Republikes se Shqiperise.

**Neni 25**

Ndryshimi dhe largimi nga vendi I punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga drejtuesi ligjor Z. Nazif Hysa. Largimi lidhet me mbarimin e kontrates se punes, per shkak te shkeljeve disiplinore te punes, ose me vete kerkesen e te interesuarit.



## **BILANCI DHE TE ARDHURAT**

### **Neni 26**

Shperblimi per personat e punesuar ne veprimtarine tregtare te shoqerise "BLEDI" shpk Burrel, caktohet sipas kontrates se punes Ndryshimi ne page vendoset nga themeluesi I shoqerise.

### **Neni 27**

Fitimi qe do te merret perbehet nga fitimi I vitit financiar te cilit I jane zbritur ose shtuar numurat respektive te humbjeve apo fitimeve te mbartura nga vitet e meparshme.

## **DISPOZITA TE FUNDIT**

### **Neni 28**

Themeluesi me rastin e futjes se ortakeve ne shoqeri kane te drejte te bejne ndryshimet e nevojshme ne statut si edhe te hartoje edhe kontraten e perbashket me ortaket, duke bere ndryshimet e nevojshme ne regjistrin tregtare prane gjukates te rrethit Tirane.

### **Neni 29**

Mosmarveshjet e shoqerise ne marredhenie me persona juridike e fizike vendas dhe te huaj, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten kur kjo nuk arrihet, zgjidhet nga gjukata e rrethit Tiranes.

### **Neni 30**

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut I referohet ligjit Nr. 7512 date 10 gusht 1991 kodit tregtare te Republikes se Shqiperise si edhe cdo akti tjeter ligjor te legjislacionit Shqiptar.

### **Neni 31**

Statuti perpilohet ne disa kopje per tju derguar organeve kompetente. Nje kopje e tij mbetet si nje pjese e dokumentacionit te formimit te shoqerise "BLEDI" shpk Burrel. U nenshkrua sot me dt. 10 shtator 1999.

**DREJTUESI LIGJOR**

( Nazif / HYSA )

